

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S. S. nga fsh.B.K.Vitisë ,kundër të paditurës S. R.St.(ud.T.V.L.), nga Vitia tani me adres të pa njohur, baza e kontestit vërtetim i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 21.06.2017, shpallë këtë;

## A K T G J Y K I M

**I. MIRATOHET** kërkesëpadia e paditësit S. S. nga fsh.B.,K.Vitisë dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.xxxx, në sipërfaqe prej xxxx m<sup>2</sup> , në vendin e quajtur “Sh D”, në bazë të Certifikatës së pronës xxxx ZK.Viti, të regjistruara në emër të pronarit juridik S.R.S. ud Trajka V.L.,nga Vitia, **në bazë të shitblerjes**.

**DETYROHET** e paditura S R.S (T V.L),nga Vitia, tani me adrese te panjohur, t’ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit S.S.nga fsh.B., K.Viti,dhe të durojnë që ngastren e lartpërmendur të regjistrojnë në emrin e paditësit.

**Ky aktgjykim** për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

**II.**Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

## A r s y e t i m

Gjykata të paditurës S. R.S. (ud.T. V.L.),nga Vitia, i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja nuk ishte kthyer, sepse i padituri ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur.

Ne seancen e dates xxxxx, paditësi S. S. deklaroi: Mbetem në tërsi pranë padis dhe kërkes padis dhe kërkoj nga gjykata që ti njihet e drejta e pronsisë në ngastren kadastrale nr.xxxxx ZK.Viti e cila ngaster është në sipërfaqe prej xxxxm<sup>2</sup>,nga se babai im H. S. këtë ngaster e kishte blerë nga e paditura diku në vitin xxxx, ku e ka paguar në tërsi ka hyre në posedim dhe shfrytëzim qe nga ai vitë pa u penguar nga askush , mirpo për shkaqe të njohura nuk ka mundur të bëne bartjen e kësaj ngastre.

Paditesi Sadulla Sejdiu i propozon Gjykatës që të paditurës ti caktohet një përfaqësues të përkohshëm, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurën av. L. E. nga Vitia.

Paditesi Sadulla Sejdiu në seancen e dt.xxxxx, i ka propozuar gjykatës që gjykata te caktoj një ekspert te gjeodezisë me qellim te identifikimit të ngastres nr.xxxxx, ZK.Viti.

Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit dhe së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalur në vendin e ngjarjes me dt.xxxxx, ka bërë identifikimin e ngastres kadastrale nr.xxxx

Ngastra nr. xxxx ZK.Viti ne vendin e quajtur "Shx Dx", e cila ngaster për nga gjastësia shtrihet lindje-perendim, ndërsa per nga gjerësia veri-jug, e cila me kulturë ishte e mbjellur misër dhe punohet nga paditësi.

Paditesi i propozojne Gjykates që për seancën e radhës të ndëgjohe dy dëshmitare qe kane njohuri lidhur me shitblerjen e kësaj ngastre. Gjykata kishte aprovuar propozimin e paditësit për ndegjimin e dy dëshmitarve që kishin njohuri mbishitblerjen e kësaj ngastre.

Dëshmitari M. S. nga fsh.xxxx ka deklaruar: Këtë ngaster e ka bler babai i paditësit H. S. nga një qytetarë i nacionalitetit serb , këtë ngaster është blere në vitin xxxx, është paguar në tërsi ku kan hyre në posedim qe nga ajo kohë edhe në shfrytezim pa u penguar nga askush, nuk kam ndëgjuar të jete ankuar ndokush nga serbet që mos të kete marr qmimin e kontraktuar. Valuta në atë kohe ka qen dinari jugosllave, dhe pagesa është bërë me dinar jugosllave.

Dëshmitari Xh. S.nga B... , ka deklaruar: Kjo ngaster për të cilen sotë qe bëhet fjale kjo gjindet nën Viti, të cilen e ka blere babai i S. S. , H. S., prej nje qytetari te nacionalitetit serb , e ka bler diku para xxxx vite, që do të thotë se është e blene para luftes. Une nuk kam ndegjuar qe është ankuar ndonjë qytetar i nacionalitetit serb , present nuk kam qen kur eshte blere kjo are , mirpo e di se eshte paguar me dinar jugosllav, se ne ate kohe ka qenë ne pordorim dinari jugosllave.

Në procedurën e provave gjykata ka: Lexuar Certifikaten e pronese, nr.xxxx, e dt.xxxxx, në emer të S.R.S. (ud.T. V.L.).Lexohet procesverbali mbi vërtetimin e gjendjes faktike i dt.xxxxx I perpiluar nga komisioni i komesacionit.Lexohet përgjegjeja e AKP,nr.xxxxx e dt.xxxx.Lexohet përgjegjeja e policis e dt.xxxx.Lexohet ekspertiza e dt.xxxxx e perpiluar nga eksperti gjeodezisë V. S..

Paditesi S. S. ne fjalen perfundimtare deklarone: Mbetem ne tersi pranë padisë dhe kerkespadi së dhe kërkoh nga gjykata që të më nihet e drejta e pronesisë ne ngastrat kadastrale xxxx ZK.Viti , ne sipërfaqe xxxx m2 , nga se pas daljes në teren nga ana e gjykates së bashku me ekspertin e gjeodezisë , ekspertizen e ekspertit te gjeodezisë, procesëverbali i komesacionit si dhe ndegjimin e dy deshmitarve , në këtë shqyrtim gjyqesor M. S., dhe Xh. S., si dhe procesverbalin e dt.xxxxx , leshuar nga komisioni për komesacion . eshte vertetuar mjaftë se ka ekzistuar nje raport juridiko civil ne mes babait tim H. S. dhe të paditurit , edhe pse ka qen i pa shkruar por me hyrjen ne posedim dhe shfrytezim qe nga vitet shtadhet (70) e gjer me sote , ka prodhuar efekt juridik, andaj kerkoj nga gjykata qe gjykata te aprovoi padin dhe kërkespadin , dhe të bejn aktgjykimin meritor conform dispozitave ligjore.

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit S. R.S.T. V.L.), av. L. E.në fjalen përfundimtare ka deklaruar, me rastin e shqyrtimit te kërkespadi te paditesit S. S. lidhur me njohjen e pronsis nga ana Gjykates , për ngastren kadastrale nr..xxx, në vendin e quajtur "Sh. D." në siperfaqe prej xxxx m2 ZK.Viti, une si perfaqesues i perkoshem i te paditures S R.S (T.V.L),pas ndegjimit te dy deshmitarve dhe provave te tjera si dhe raportit te ekspertit gjeodet lidhur me

identifikimin e kesaj ngastre te cekur me lart mbeten ne autoritetin e gjykates qe ne pajtim me ligjin te vendos sipas bindjes se vete.

Gjykata analizoi thënjet e palëve ndergjygyse, provat e administruara dhe konstatoj: se ngastra katastrale nr. xxxxx, e evidentuar ne emër të të paditurës S.R.. (ud.T.V.L.),që vertetohet në bazë të qertifikatës së prones me numër xxxx zona katastrale Viti, të cilen ngastër babai I paditësit e kishte blerë nga S. R.S. (ud.T. V.L.). Babai I paditësit S. S., Hashim S. e ka paguar në tersi qmimin e shitblerjës të ngastres kadastrale, ka hyrë në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush ku kjo është vertetua nga deklaratat e dëshmitarve si dhe daljës së gjykatës në vendin e ngjarjës, nga keto arsye i njihet e drejta e pronsisë, paditësit S. S. nga fshati B....si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE VITI**

**C.nr. 84/2015**

**Me 21.06.2017**

Sekretare Juridike:  
Azize Rama

Gj y q t a r i  
Nexhat Aliu

**KESHILLA JURIDIKE:**Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtinë, përmes kesaj gjykate.